



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 762 prot.

Tiranë, më 16. 05. 2024

V E N D I M

Nr. 139, datë 16. 05. 2024

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,² shqyrtoi ankesën nr. 22 Regj., datë 13.02.2024, që i përket ankuesit Fondacioni “Së Bashku”, në të cilën pretendohet për diskriminim të personave me aftësi të kufizuara nga Prefektura e Qarkut Lezhë, lidhur me garantimin aksesueshmërisë së godinës së saj.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit pala ankuese shpjegon se, nga vëzhgimet e bëra në qytetin e Lezhës, ndër të tjera kanë konstatuar problematika lidhur me aksesueshmërinë në godinën e Prefekturës së Qarkut Lezhë për personat me aftësi të kufizuara. Sipas pretendime të subjektit ankues, kjo ndërtesë, nuk garanton për personat me aftësi të kufizuara, ofrimin e shërbimeve të saj në kushte të barabarta me qytetarët e tjerë, pasi evidentohet mungesa e rampës në pjesën hyrëse të godinës, mungesa e elementëve me teksturë/reliev jashtë dhe brenda godinës për të udhëhequr personat me aftësi të kufizuara në shikim, mungesa e sporteleve të përshtatura për ta (pasi janë shumë të larta), mungesa e ashensorit për katet e sipërme, si dhe mungesa e parkimit të rezervuar për personat me aftësi të kufizuara. Në këtë kuptim, pala ankuese pretendon se është diskriminuar për sa kohë që dispozitat ligjore të aktit normativ, VKM-së nr. 1503, datë 19.11.2003 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara””, nëpërmjet të cilave PAK janë përfitues në mënyrë të drejtpërdrejtë, nuk zbatohen nga ana e Prefekturës së Qarkut Lezhë.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Sa më sipër, pala ankuese kërkon nga Komisioneri:

- konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar që përfitojnë shërbimin, në Prefekturën e Qarkut Lezhë;
- përmirësimin e situatës së aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara të godinës së Prefekturës së Qarkut Lezhë;
- zbatimin e të gjitha standardeve teknike dhe ligjore të aksesueshmërisë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me vendimin nr. 427, datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së tij mbrojtjen e interesave të komunitetit të grupeve të përjashtuara në Shqipëri (*duke përfshirë gratë, të moshuarit, fëmijët dhe të rinjtë që vijnë nga familje dhe shtresa të ulëta social-ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë romë, etj*).

Bazuar në ankesën e paraqitur, Fondacioni “Së Bashku” pretendon mohimin e barazisë dhe diskriminimin e personave me aftësi të kufizuar lidhur me mohimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara (PAK), në godinën e Prefekturës së Qarkut Lezhë.

Pala ankuese pretendon se është diskriminuar për sa kohë që dispozitat ligjore të aktit normativ, VKM-së nr. 1503, datë 19.11.2003 “*Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*”, nëpërmjet të cilave PAK janë përfitues në mënyrë të drejtpërdrejtë, nuk zbatohen nga ana e Prefekturës së Qarkut Lezhë.

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa “b”, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, parashikohet:

“1. Komisioneri ka kompetencë: b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive...”

Bazuar në nenin 4, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ku përcaktohen subjektet e ligjit, parashikohet:

- 1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*
- 2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.*
- 3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.*

Bazuar në dispozitën e mësipërme rezulton se kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund ta bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të çënohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së Fondacionit dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur.

Bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara, pala ankuese, Fondacioni “Së Bashku”, në cilësinë e personit juridik, është subjekt i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi, në kuadër të përfaqësimit të interesave të gjithë grupit të personave me AK, të cilët janë përfitues të VKM-së nr. 1503, datë 19.11.2003 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara””.

Shkaku i pretenduar nga pala ankuese, *aftësia e kufizuar*, është shkak i mbrojtur nga neni 1, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 2, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “2. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”.

Bazuar në nenin 7, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato:

- a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*
- b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.*

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: ...

- c) kontributin dhe mundësinë për të përfutur të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun...”*

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me anë të shkresës nr. 289/1 prot., datë 20.02.2024, Komisioneri i është drejtuar Prefektit të Qarkut Lezhë, duke kërkuar informacion sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Prefekti i Qarkut Lezhë, me shkresën³ nr. 180/1 prot., datë 26.02.2024, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë e ushtron veprimtarinë në bazë të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” dhe në fushën e përgjegjësisë referuar nenit 8 të këtij ligji nuk është ofrimi i shërbimeve të drejtpërdrejta të asnjë lloji natyre të cituara në nenin 20 të ligjit nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Misioni i Prefektit të Qarkut është përmbushja e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Këshillit të Ministrave, në nivel qarku.

Për sa më sipër nuk jemi në kushtet e diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuara. Për pikat e tjera të kërimit, ju bëjmë me dije se:

- *Nga ana e institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë do të merren të gjitha masat e nevojshme për vendosjen e një rampe në pjesën hyrëse të institucionit për të bërë të mundur aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara si dhe përshtatjen e një zyre në kat të parë të godinës për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.*
- *Përshtatja e katit të dytë është e pamundur pasi godina e institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë është ndërtesë dy katëshe me ambiente të përbashkëta me godinën e Bashkisë Lezhë, e*

³ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 289/2 prot., datë 27.02.2024.

ndërtuar para viteve 90” dhe projekti i godinës ekzistuese e bën të pamundur ndërtimin e ashensorit apo ndërtimin e elementëve me teksturë/reliev jashtë dhe brenda godinës”.

2. Me shkresën nr. 289/3 prot., datë 28.03.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ju drejtua sërish Prefektit të Qarkut Lezhë duke e informuar lidhur me pretendimet e subjektit ankues, për të cilat nuk ishin dhënë parashtrime në shkresën e sipërcituar, si dhe duke kërkuar informacion mbi afatet dhe projektin për plotësimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Prefekti i Qarkut Lezhë, me shkresat⁴ nr. 276/1 prot. dhe nr. 276/2, datë 05.04.2024, informoi Komisionerin lidhur me hapat e ndërmarrë për plotësimin e kushteve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në godinën e tij. Fillimisht me shkresën 276/1 prot., datë 05.04.2024, e cila iu përcoll Komisionerit për dijeni, Prefekti i Qarkut Lezhë, i ishte drejtuar Ministrisë së Brendshme duke e informuar dhe kërkuar ndër të tjera se: “*...Pranë institucionit të Prefektit janë depozituar shkresat nr. 209/1, datë 20.02.2024 “Njoftim dhe kërkesë për informacion” dhe nr. 289/3 “Kërkesë për informacion” të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtoria e Hetimit Administrativ, bazuar në ankesën e bërë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nga ankuesi Fondacioni “Së Bashku”, lidhur me garantimin e aksesueshmërisë së godinës së Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë për personat me aftësi të kufizuar, pasi evidentohet mungesa e rampës dhe sinjalistikës orientuese për personat e verbër, kjo në mbështetje të nenit 32/1b dhe nenit 33 të ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” të ndryshuar. Në mosrealizimin e kësaj infrastrukture të nevojshme për personat me aftësi të kufizuar Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë penalizohet me gjobë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.*

Sa më sipër për ndërtimin e saj, referuar projektit dhe preventivit kërkohet një shpenzim në vlerën rreth 200.000 lekë.

Meqenëse për vitin 2024 nuk kemi të planifikuar në buxhet fonde për investime, kërkojmë akordim fondi për këtë shpenzim...”.

Bashkëlidhur shkresës së sipërcituar, Prefekti i Qarkut Lezhë citon se i ka përcjellë Ministrisë së Brendshme edhe kopje të Projektit dhe Preventivit të punimeve që kërkohet të kryhen.

Me shkresën nr. 276/2 prot., datë 05.04.2024, Prefekti i Qarkut Lezhë theksoi ndër të tjera se: “*...i jemi drejtuar Ministrisë së Brendshme “Kërkesë fondi për investime” shkresë të cilën ua kemi dërguar edhe juve për dijeni.*

Ndërhyrjet në katin e dytë të godinës janë të pamundura për shkak të projektit ekzistues. (hyrja dhe shkallët shumë të ngushta)

Për sa i përket parkingut të rezervuar për personat me aftësi të kufizuar ju bëjmë me dije se hapësira para institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë është në pronësi të Bashkisë Lezhë dhe

⁴ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 289/4 prot. dhe nr. 289/5 datë 08.04.2024.

është kjo e fundit që bën menaxhimin e hapësirave publike dhe miraton parkingjet e rezervuara për personat me aftësi të kufizuara.

Në lidhje me mungesën e sporteleve të përshtatura për ta (pasi janë shumë të larta)...

Siç ju kemi cituar edhe në shkresën nr. 180/1 prot., datë 26.02.2024, Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë nuk ofron shërbime sipas përcaktimeve të cituara në nenin 20 të ligjit nr. 10221/2010 dhe për këtë arsye nuk ka patur asnjëherë sportele për pritje qytetarësh (ku ju citoni në shkresë se janë shumë të larta).

Lidhur me kohën që do të na nevojitet për të përfunduar plotësimin e kushteve të aksesueshmërisë së godinës, për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara sqarojmë se: Siç theksuam edhe më sipër në shkresë i jemi drejtuar Ministrisë së Brendshme për të na mundësuar çeljen e fondit për të mundësuar për aq sa është e mundur plotësimin e kushteve të aksesueshmërisë së godinës për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara. Në buxhetin e dërguar nga Ministria e Brendshme për vitin 2024 për Prefektin e Qarkut Lezhë nuk ka të miratuar asnjë zë për investimet.

Mbështetur në VKM-në nr. 1691, datë 10.10.2007 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme, për prefektët dhe administratën e tyre, nënprefektët dhe administratën e tyre dhe për Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile (Drejtoria të PMNZSH-së”, godina e institucionit tonë është vetëm në përgjegjësi administrimi nga Prefekti i Qarkut për të ushtruar veprimtarinë si institucion, ndërsa çdo lloj investimi duhet të bëhet me miratim nga Ministria e Brendshme. Nuk mund të bëjmë asnjë lloj ndërhyje në objekt pa miratimin e kësaj të fundit.

Krijimi i infrastrukturës së nevojshme për PAK kërkon ndryshim të infrastrukturës (prishje të shkallës ekzistuese, përshtatje zyre etj.) Për këtë arsye ne i jemi drejtuar Ministrisë së Brendshme duke i dërguar projektin dhe preventivin përkatës të punimeve për miratim të fondit të investimeve për të mundësuar atë çfarë ju kërkoni.

Në momentin që Ministria e Brendshme do të miratojë projektin dhe do të bëjë çeljen e fondit të kërkuar për investime, nga ana jonë do të merren të gjithë hapat e duhur ligjorë për realizimin infrastrukturës së nevojshme, për aq sa është e mundur, për personat me aftësi të kufizuara.”

3. Në vijim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri përmes e-mailit datë 22.04.2024, i përcolli subjektit ankues përgjigjet e vëna në dispozicion nga ana e Prefektit të Qarkut Lezhë.

Pasi është njohur me qëndrimin e provat e sjella nga Prefekti i Qarkut Lezhë, përfaqësuesja e Fondacionit “Së Bashku”, nëpërmjet e-mail-it të dërguar me datë 10.05.2024, është tërhequr nga ankesa e bërë pranë KMD-së, pasi ka vlerësuar masat e marra nga e institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë, pas ndërmjetësimit të Komisionerit, lidhur me masat e marra sa i përket garantimit të kushteve të aksesueshmërisë së godinës për personat me aftësi të kufizuara.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është

paraqitur ankesa”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “*Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ*”.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i cili parashikon se: “*Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë*”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 22, datë 13.02.2024, të Fondacionit “Së Bashku”, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Aftësia e kufizuar)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)